



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GRAMATIKË E ZBATUAR TE GJUHËS FRËNGE

Ngarkesa: 6 kredite. 60 ore seminare

Viti akademik/semestri kur zhvillohet: Viti I /semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë me detyrim

Programi i studimit: Bachelor në Gjuhë Frënge dhe Gjuhën e Shenjave Shqipe

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Lënda e gramatikës së aplikuar është konceptuar sipas një plani kryesisht praktik. Përdorimi i moderuar i rregullave gramatikore të gjuhës frënge, nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme gramatikore, do t'i mundësojë studentit familjarizimin me këto rregulla dhe me vështirësitë e një gjuhe, që atij mund t'i duket e mbushur me rregulla përjashtimore. Lënda përmban ushtrime dhe tekste të grupuara sipas tematikave të përcaktuara në program. Për çdo çështje gramatikore të pasqyruar në program, janë parashikuar aktivitete/ushtrime të përshtatura me nivelet gjuhësore të studentëve .

Objektivat specifike lëndore:

Synohet që studenti

- të arrijë të marrë njohuritë bazë të lëndës dhe të përforcojë detyruesisht rregullat gramatikore të nivelit A1, A2, B1
- Të dallojë dhe përdorë korrektësisht nyjet
 - Të zbatojë rregullat e formimit të gjinisë dhe të numrit të emrit të përgjithshëm
 - Të njohë dhe përdorë siduhetmbiemrat cilësor, ndajfoljet, parafjale të nënfjali.